

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i përgjithshëm Divizioni Penal, përmes gjyqtares së vetme gjykuese Snezhana Mihajloviq, me sekretaren juridike Suzana Kovaçeviq, në lëndën penale kundër të pandehurit L.H. nga ..., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nënparagrafin 1.4 të KPRK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan PP.nr.49/18 të datës 25.01.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit publik gjyqësor, me datën 28.03.2018 në prezencë të palëve publikisht shpalli

A K T G J Y K I M

I akuzuari L.H. nga babai B. dhe nëna Sh., e lindur P., i lindur më ..., në ..., jeton në lagjen ... rr. ... nr. ..., ka të përfunduar shkollën e mesme, i papunë, i pamartuar, i gjendjes së varfër ekonomike, deri më tani i pagjykuar, nuk zhvillohet procedurë për veprën tjetër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Me datën 30.12.2017, rreth orës 15:30 minuta, në Gjilan në rrugën ..., te ish “ ... ” lehtë e ka lënduar të dëmtuarën S.E. nga ... dhe i ka shkaktuar pengesë të përkohshme për shëndetin e saj, në atë mënyrë që pas një zënke verbale, në fillim të dëmtuarën e ka tërhequr për dorën e majtë e pastaj me grushta dhe shuplaka disa herë e ka goditur në pjesë të fytyrës, duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore në formë të ënjturave dhe ndrydhjeve të indeve të buta në pjesën pariale dhe gërvishtje në dorën e majtë.

-me çka ka kryer veprën penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nënparagrafin 1.4 të KPRK.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 4,41,42,49,50,51,52,73 dhe 74, KPRK si dhe nenit 248 KPRK, e gjykon me

DËNIM ME KUSHT

I.Të akuzuarit i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej (3) tre viteve nuk kryen tjetër veprën penale, në të kundërtën dënimi me kusht ka për tu revokuar.

II.E dëmtuara S.E. nga ... rr.” ... ” p.n. udhëzohet që të drejtën e saj pasurore-juridike ta realizoj në kontes civil.

III. I akuzuari obligohet që në emër të paushallit të paguaj shumën prej 25 euro dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate në afat prej 15 ditëve.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit L.H. nga ... për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nënparagrafin 1.4 të KPRK.

Gjatë dëgjimit të parë të mbajtur me datë 28.03.2018, ku është lexuar aktakuza nga Pokurori i Shtetit PP.nr.49/18 e datës 25.01.2018 dhe pas leximit të aktakuzës, i pandehuri ka deklaruar se sa kuptuar aktakuzën dhe veprën penale që i vihet në barë. I pandehuri L.H. në mbrojtjen e tij e ka cekur që e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale që i vihet në barë, që e pranon fajësinë për të cilën akuzohet, që në rast të xhelozisë ka reaguuar, përndryshe ajo është e fejuara e tij me të cilën së shpejti do të martohet. Pendohet për kryerjen e veprës penale me premtimin që asnjëherë më nuk do ta godas vajzën e tij dhe lut gjykatën që ta dënojë me një dënim më të butë.

Në shqyrtimin e parë publik gjyqtarja individuale ka marr aktvendim me të cilën është pranuar pranimi i fajësisë, pasi që ka konstatuar që janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Gjyqtari individual ka konstatuar se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, që pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare nga ana e të pandehurit, që pranimi i fajësisë bazohet në faktet lëndore të cilat i përmban aktakuza dhe që aktakuza nuk përmban asnjë të metë ligjore sa i përket fakteve.

Gjykata analizoi faktet që ndodhen në shkresat e lëndës, kurse me vet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, ka ardhë në përfundim që i akuzuari ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nënparagrafin 1.4 të KPRK.

Neni 188 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 parasheh që çdo person që i shkakton lëndime të lehta trupore tjetrit që shkaktojnë pengesë të përkohshme në shëndetin e personit tjetër do të dënohet me gjobë ose dënim me burg deri në një vit.

Pasi që veprimet e të pandehurit përmbajnë elemente të veprës penale lëndim i lehtë trupor, i pandehuri është shpallur fajtor dhe i dënuar si e parasheh ligji.

Në bazë të nenit 73 dhe 74 të KPRK-ës gjatë shqiptimit të dënimit kundër të pandehurit gjyqtarja individuale ka marr parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Si rrethanë lehtësuese gjykata për të pandehurin ka marr që i pandehuri është i ri, i dashuruar, që ka vepruar në afekt, që deri më tani nuk ka qenë i gjykuar, dhe nuk zhvillohet procedurë për vepër tjetër penale.

Rrethana rënduese nuk ka pasur.

Sipas besimit të gjykatës dënimi me kusht i shqiptuar ndaj të pandehurit paraqet dënim që është i drejtë në përputhje me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjykata konstatoi që edhe me këtë dënim mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-ës, që në të ardhmen i pandehuri mos të kryej vepra tjera penale, që të parandalojë persona tjerë nga kryerja e veprave penale, dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke pas parasysh natyrën e kësaj vepre penale dhe gjendjen financiare të pandehurit gjyqtarja në bazë të nenit 451 paragrafi 1 të ZKP-ës, ka vendosur që të pandehurin ta obligoj të paguaj vetëm paushallin gjyqësor në shumën prej 25 euro në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nga të cekurat e mësipërme është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i përgjithshëm

P.nr.113/17 me datë 28.03.2018

Sekretarja juridike,

Suzana Kovaçević

Gjyqtarja e vetme gjykuese,

Snezhana Mihajloviq

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në dy kopje dorëzohet përmes kësaj gjykate.

Përktheu:
Ardijana Aliu